

University for Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Spring 4-2020

Pronësia intelektuale, vlerësim krahasimor Kosovë-Shqipëri

Labinot Avdiu

University for Business and Technology - UBT

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Law Commons](#)

Recommended Citation

Avdiu, Labinot, "Pronësia intelektuale, vlerësim krahasimor Kosovë-Shqipëri" (2020). *Theses and Dissertations*. 1933.

<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/1933>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.



Kolegji UBT
Fakulteti Juridik

**Pronësia intelektuale, vlerësim krahasimor Kosovë-Shqipëri Shkalla
Bachelor**

Labinot Avdiu

04/2020
Prishtinë



Kolegji UBT
Fakulteti Juridik

Punim Diplome
2013-2014

Labinot Avdiu

Pronësia intelektuale, vlerësim krahasimor Kosovë-Shqipëri

Mentori:
Dr.Sc. Altin Maliqi

04 / 2020

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të pjeshme për Shkallën Bachelor

Abstrakt

Pronësia intelektuale është një kategori e pronës që përfshin produktet e pa prekshme të intelektit të njeriut. Ekzistojnë disa lloje të pronësisë intelektuale si: e Drejta e Autorit, Patenta, Markat Tregtare, Dizajni Industrial, Sekretet Industriale etj. dhe disa shtete i njohin këto të drejta dhe disa jo. Aktualisht kjo e drejtë studihet e ndarë në dy degë kryesore: E Drejta e Autorit dhe E Drejta e Pronësisë Industriale. Origjina e pronësisë intelektuale moderne mund ti gjejmë në Anglinë e shekullit 17 dhe 18 mirëpo pronësia intelektuale gjen zbatim, sigurohet dhe garantohet në shumicën e legjislativave të botës në shekullin e XX.

Lidhur me mënyrën se si kjo e drejtë funksionon dhe është rregulluar në Kosovë, mund të themi se, Kosova aktualisht ka krijuar një strukturë të mirë ligjore, institucionale dhe po punon për të rritur shkallën e ndërgjegjësimit dhe botëkuptimit në komunitet. Zbatimi i ligjit dhe garantimi i mbrojtjes të drejtave janë një tjetër fokus i Qeverisë së Kosovës ku paralelisht po punohet me avancimin, kualifikimin dhe trajnimet e stafit që punon në secilën prej hallkave të këtij sistemi. Një tjetër synim i përsosjes të kësaj të drejte në Kosovë është edhe bashkëpunimi me shtetet e tjera dhe me organizmat ndërkombëtare si WIPO dhe me organizata të ndryshme që monitorojnë dhe avancojnë këtë disiplinë të së drejtës.

Fjalët Kyçe: Pronësia Industriale, E Drejta e Autorit, Pronësi Industriale, Mbrojtje, Regjistrim.

MIRËNJOHJE/FALENDERIME

Ky punim diplome nuk do të ishte i mundur pa kohën, mbështetjen dhe përkushtimin e shumë njerëzve përreth meje gjate këtyre viteve, falë ndihmës së pakursyer të kolegeve për të cilët ndiej detyrim t'i falënderoj me shumë respekt.

Ndiej nevojën për të falënderuar gjithë stafin e profesorëve të fakultetit, në mënyrë të veçantë profesorët e departamentit të juridikut, të cilët me punë dhe pasion përcollën tek unë përgjatë katër viteve, të nivelit bachelor, njohuritë e nevojshme, për tu zhvilluar, formuar dhe për të paraqitur para jush këtë punim kaq serioz.

Isha e privilegjuar të përballesh me përvojën e profesorëve kritik e pasionant për punën e tyre të cilët mund të bëjnë ndryshimin. Me inspiruat me entuziazmin e juaj dhe dedikimin, mbështetjen intelektuale dhe konfidencë për punën time.

Dëshiroj të falënderoj shumë nga më të afërmit në jetën time, për mirëkuptim dhe interesimin e tyre për të më dhuruar ndihmën dhe kënaqësinë e jetës gjatë këtyre viteve të studimit.

Në fund, por jo edhe të fundit, falënderime te veçanta ju shpreh atyre pa të cilët vështirë se do të isha këtu ku jam sot, pa dashurinë, kujdesin, besimin dhe mbështetjen e pakursyer të tyre, prindërve të mi.

Dy fjale janë te pamjaftueshme për te shprehur mirënjohjen time, për më tepër, me shumë siguri, as të gjitha fjalët që i njoh nuk arrijnë këtë.

Ju faleminderit!

Përmbajtja

Lista e Figurave.....	V
Lista e tabelave.....	VI
1. Hyrja	1
1.1. Hyrje	1
1.2. Motivimi	1
1.3. Përshkrimi i problemit.....	1
2. Pronësia Intelektuale	3
2.1. Patentat	3
2.2. Markat tregtare (Trademarks).....	3
2.3. Dizajnet.....	4
2.4. Sekretet Tregtare.....	4
2.5. Treguesit Gjeografik.....	4
2.6. Të drejtat e autorit.....	5
2.7. Gjendja e Tanishme	5
2.7.1. Legjislacioni kombëtarë i pronësisë intelektuale në Kosovë	5
2.7.2. Legjislacioni Kombëtarë i pronësisë intelektuale në Shqipëri	6
2.8. Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO).....	7
2.8.1. WIPO – Historiku	7
2.8.2. WIPO- Qëllimi	7
2.9. Sistemi i Madridit	8
2.9.1. Zbatimi i Sistemit të Madridit	8
2.9.2. Kostot	9
2.10. Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI).....	10
2.10.1. DPPI – Historiku	10
2.10.2. DPPI– Misioni.....	10
2.10.3. Baza ligjore kombëtare e DPPI	12
2.10.4. DPPI organizatat, marrëveshjet dhe traktatet.....	12
2.10.5. Strategjia e DPPI-së për vitet 2016-2020	13
2.10.6. Raporti vjetor i vitit 2018 DPPI	13
2.10.7. Markat Tregtare (DPPI)	15
2.10.8. Dizajnet industriale dhe të dhënat statistikore.....	16
2.10.9. Treguesit gjeografik	16

2.11.	Agjensioni për Pronësi Industriale (API).....	18
2.11.1.	API – Historiku	18
2.11.2.	API - Patentat	20
2.11.3.	API - Markat Tregtare	20
2.11.4.	API - Dizajnet Industriale	21
2.11.5.	API - Treguesit Gjeografik.....	22
2.11.6.	Digjitalizimi i API.....	22
2.11.7.	Të hyrat financiare të API.....	22
3.	Deklarimi i problemit.....	24
4.	Metodologjia.....	25
5.	Konkluzioni.....	26
6.	Referencat	27

Lista e Figurave

Figure 1 Rregullimi organizativ I brendshëm I DPPI-së.....	11
Figure 2 Aplikimet e Patentave Evropiane në Republikën e Shqipërisë.....	15
Figure 3 Statistika për aplikimin e Markave Tregtare API	21
<i>Figure 4 Statistika mbi numrin e aplikimeve për Dizajn industrial në API.....</i>	<i>21</i>
Figure 5 Të hyrat financiare të API ndër vite.....	23

Lista e tabelave

Table 1 Të dhëna Statistikore 2016-2018	14
Table 2 Statistika e shkresave të pranuar në vitin 2018 në API	19

1. Hyrja

1.1. Hyrje

Me zhvillimin e hovshëm të industrisë në shekullin 17 dhe 18 shpikësit, autorët nga ku kompanitë filluan të ndërmarrin hapa për të mbrojtur në mënyrë të ligjshme shpikjet dhe krijimet e tyre. Ndër shtetet e para që filluan të aplikojnë këto ligje ishte Anglia ku me Statutin e Monopoleve ata filluan të lëshojnë patenta për një numër të caktuar të viteve. Ky Statut bëhet themel për zhvillimet e mëtutjeshme të legjislacioneve për patenta në mbarë botën.

Në këtë punim diplome ne do të bëjmë një vlerësim mbi konceptet dhe nocionet juridike të pronësisë intelektuale, do të trajtojmë si të veçantë të gjitha asetet e kësaj pronësie si dhe do të trajtojmë në një fokus krahasimor ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, lidhur me legjislacionit të tyre për pronësinë intelektuale ku do të shohim se si mbrohet pronësia intelektuale në këto dy vende dhe cila është më efikase.

1.2. Motivimi

Ne jetojmë në një kohë ku zhvillimi industrial dhe intelektual ka marrë një hov të pa ndalshëm, ku shpikjet dhe prodhimet e mendjes njerëzore ndodhin në baza ditore. Kosova si shtet i ri dhe Shqipëria me ligje relativisht të reja tentojnë çdo herë e më shumë të t'u mundësojnë shpikësve, artistëve, korporatave të ndryshme që të mbrojnë krijimtarinë e tyre intelektuale dhe shpikjet, në mënyrë ligjore më lehtë. Qëllimi i këtij hulumtimi është që të bëjmë krahasimet në mes të legjislacioneve të këtyre dy vendeve dhe aplikimin e ligjeve të pronësisë intelektuale në këto dy vende.

1.3. Përshkrimi i problemit

Pronësia intelektuale është çështje me rëndësi në të gjitha shtetet e botës, mirëpo në Kosovë aplikimi i saj është pothuajse jo ekzistent, Shqipëria në anën tjetër është në pozitë më të favorshme dhe pronësia intelektuale gëzon mbrojtje më të madhe, kjo për faktin se kalimi midis këtyre dy shteteve qëndron në

faktin se Kosova nuk është anëtare e WIPO-s ndërsa Shqipëria është anëtare dhe për këtë pozitë përfiton më shumë mbështetje dhe asistencë ndërkombëtare për zhvillim. Në këtë punim do të diskutojmë të gjitha këto probleme dhe të kuptojmë se pse ndodh kjo.

2. Pronësia Intelektuale

2.1. Patentat

Patenta është një e drejtë ligjore për të bërë apo për të shitur një shpikje për një numër të caktuar vitesh. Patentat jepen për shpikje teknike. Kërkesa për patenta shqyrtohet nga zyra ku është depozituar Kosovë (KIPA¹), dhe Shqipëri (DPPI²) në mënyrë që të plotësojë kërkesat e rrepta për dhënien e një patente. Sipas të dy legjislacioneve kohëzgjatja e një patente është 20 vjet. Patenta është një e drejtë ekskluzive e dhënë për një shpikje, e cila mund të jetë një produkt ose një proces, i cili sjell një mënyrë të re të krijimit të diçkaje, ose ofron një zgjidhje teknike të re të problemit. Patentat lëshohen për shpikje të cilat janë të reja, përmbajnë hap shpikës d.m.th. duke pasur parasysh arritjen e mëparshme, shpikja nuk ka qenë e kapshme nga një person i kualifikuar në fushën e arritjes, ku përfshihet ajo, gjithashtu shpikja duhet të jetë e zbatueshme në industri, përshtirë edhe bujqësinë.

2.2. Markat tregtare (Trademarks)

Markat tregtare janë shenja dalluese që tregojnë brumin e një produkti apo shërbimi. Ato përfshijnë emrat, llogot, ngjyrat e përdorura për produktet apo shërbimet e pronarit, të cilat dallojnë nga produktet dhe shërbimet e ofruara nga konkurrentët. Marka është një fjalë, simbol, vizatim, apo kombinim i fjalëve, i frazave, simboleve apo vizatimeve që identifikojnë dhe dallojnë burimin e mallrave të një pale nga ato të një pale tjetër. Përkufizimi i markës së shërbimit është i njëjtë me atë të markës tregtare, me përjashtim që ato identifikojnë dhe dallojnë burimin e shërbimeve dhe jo produktet një kategori tjetër e pronësisë industriale përfshin tregtinë emrat dhe përcaktimet. Një emër tregtar ose tregtar është ai emrin ose përcaktimin që identifikon një kompani. Në shumicën e vendeve, emrat e tregtisë mund të regjistrohen në një autoritet qeveritar. Sidoqoftë, sipas nenit 8 të Konventës së Parisit, a emri tregtar duhet të mbrohet pa detyrimin e paraqitjes ose regjistrimit, pavarësisht nëse ajo është pjesë e një marke tregtare. Mbrojtja në përgjithësi do të thotë që emri tregtar i një kompanie nuk mund të përdoret nga një kompani tjetër, qoftë si emër tregtar ose markë tregtare ose shërbimi - dhe që një emër ose emër i ngjashëm me emrin tregtar mund të mos përdoret nga një kompani tjetër nëse ajo ka të ngjarë të mashtrrojë publikun.

¹ KIPA – Kosovo intellectual property agency

² DPPI – Drejtoria e përgjithshme e pronësisë industriale

2.3. Dizajnet

Dizenio është aspekti estetik apo ornamental i një prodhimi. Termi “dizenio” përdoret për të përcaktuar karakteristikat tredimensionale, të formave dhe sipërfaqeve, si dhe atyre dy dimensionale që janë vizatimeve, vijave apo ngjyrave, të aplikuara në produkte industriale dhe të cilat i japin produktit një paraqitje tërheqëse për konsumatorin. Dizajnet e regjistruara mbrojnë pamjen e jashtme të një produkti. Për tu regjistruar zyrtarisht dizajnet duhet të jenë origjinale dhe të veçanta. Aspektet artistike të një dizajni (llogo) gëzojnë mbrojtje edhe nga e drejta e autorit. Duhet të ceket që edhe dizajnet e pa regjistruara gëzojnë mbrojtje. Me automatizëm autori fiton mbrojtjen e dizajnit të tij kur ai e paraqet atë për publikun dhe i jep atij të drejtën për të ndaluar dikë për ta kopjuar atë.

2.4. Sekretet Tregtare

Sekretet tregtare janë alternativë ndaj patentave. Ato mbulojnë një informacion jo të njohur për publikun. Nëse përdoruesi i informacionit është i kujdesshëm për ta ruajtur atë, ai mund të padisë këdo që e vjedh atë.

2.5. Treguesit Gjeografik

Treguesit gjeografikë identifikojnë një produkt me origjinë në territorin e një vendi ose të një rajoni, ose të një lokaliteti në atë territor, ku një cilësi specifike, reputacion apo karakteristikë tjetër e mirë janë për shkak të origjinës gjeografike të produktit. Shembull tipik i një treguesi gjeografik është Djathi Parmezan i cili prodhohet vetëm në provincat e Parmës (Itali) dhe Reggio Emilia (Itali) dhe gëzon mbrojtjen PDO³ në Unionin Evropian. Treguesi gjeografik tregon që një produkt është prodhuar në një vend të caktuar dhe ka karakteristika të caktuara që janë të lidhura me vendin e prodhimit. Ai mund të përdoret nga të gjithë prodhuesit që prodhojnë produktet e tyre në vendin e treguar nga treguesi gjeografik dhe që mbartin cilësi tipike të atij vendi. Aplikimi duhet të përmbajë: emrin dhe adresën e aplikantit; përcaktimin e produktit; përcaktimin e kufijve të lokalitetit gjeografik; një raport për vetitë e karakteristikat e mallrave dhe lidhjen e tyre me mjedisin e origjinën gjeografike; një dokument të lëshuar nga autoriteti përkatës, në përputhje me pikën 2 të nenit 177 të këtij ligji; një dokument të lëshuar nga

³ PDO - Protected Designation of Origin

autoritetet vendore, që vërteton kryerjen e veprimtarisë prodhuese të aplikantit në rajonin gjeografik të dhënë. Aplikimi shoqërohet me dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse.

2.6. Të drejtat e autorit

E drejta e autorit lidhet me letrare dhe artistike krijime, të tilla si: libra, muzikë, piktura dhe skulptura, filma dhe vepra të bazuara në teknologji (të tilla si kompjuteri) programeve dhe bazave të të dhënave elektronike). Në gjuhë të caktuara, të drejtat e autorit i referohen si të drejta të autorëve. Edhe pse ligjet ndërkombëtare kanë sjellë një konvergencë, ky dallim pasqyron një ndryshim historik në evolucionin e këtyre të drejtave që ende reflektohet në shumë sisteme të të drejtave të autorit. Shprehja e të drejtës së autorit i referohet aktit të kopjimit të një vepre origjinale, e cila, në lidhje me krijimet letrare dhe artistike, mund bëhet vetëm nga autori ose me lejen e autorit. Shprehja e autorëve të drejtat i referohen krijuesit të një artisti vepra, autori i saj, duke nënvizuar kështu që, si të njohura në shumicën e ligjeve, autorët kanë disa të drejta specifike në krijimet e tyre

E drejta e autorit mbron çdo prodhim të mendjes njerëzore, me kusht që ky prodhim të jetë një shprehje, dhe jo thjesht një ide apo proces. Kjo shprehje duhet të jetë origjinale dhe të jetë e dëshmuar se i përket autorit. Shembuj të këtyre krijimeve mund të jenë në fushat artistike, letrare dhe shkencore ku përfshihen veprat letrare, muzikore, artistike, artikujt shkencorë, programet kompjuterike si dhe bazat e të dhënave.

2.7. Gjendja e Tanishme

2.7.1. Legjislacioni kombëtarë i pronësisë intelektuale në Kosovë

Legjislacioni kombëtarë momental i pronësisë intelektuale në Kosovë është i bollshëm edhe pse në praktikë lë për të dëshiruar. Ligjet të deri tashme në Kosovë prekin të gjitha sferat e pronësisë intelektuale. Gjithashtu në Kosovë funksionon relativisht mirë struktura ligj zbatuese e krijuar nga shteti ku hyjnë të gjitha institucionet përgjegjëse të cilat janë kompetente në zbatimin e ligjeve të Pronësisë Intelektuale, si dhe garantuese të mbrojtjes të këtyre të drejtave nga mbajtësit e tyre. Ndër institucionet më të rëndësishme mund të përmendim: API, Drejtorinë e të Drejtës së Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, Ministrinë e Drejtësisë, Drejtorinë e Doganave, Ministrinë e Rendit, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Tregtisë dhe Industrisë, Ministrinë e Kulturës, Arsimit dhe Shkencës, etj. Po ashtu, edhe legjislacioni në Republikën e Kosovës, aktualisht është duke u plotësuar dhe ekuivalentuar me atë të BE-së në kuadër edhe të MSA-së, si dhe duke u mbështetur edhe me akte të tjera ndihmëse nënligjore të cilat garantojnë mbrojtjen ligjore të këtyre të drejtave.

Disa nga ligjet e miratuara deri më tani janë:

Ligji për dizajn Industrial, Ligji për Patenta, Ligji për Markat Tregtare, Ligji për Treguesit Gjeografik dhe Emërtimet e Origjinës si dhe Ligji për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara.

2.7.2. Legjislacioni Kombëtarë i pronësisë intelektuale në Shqipëri

Legjislacioni Kombëtarë momental i pronësisë intelektuale në Shqipëri është i ngjashëm me atë të Kosovës mirëpo Shqipëria është vend anëtar i WIPO-s, pjesë e disa marrëveshjeve dhe traktateve ndërkombëtare e cila e vë Shqipërinë në situatë më të sigurtë ligjore se sa Kosovën e cila me mos pjesëmarrjen në këto marrëveshje e ka të vështirë të sigurojë patentat e lëshuara nga Zyra e saj. Disa nga marrëveshjet ku Shqipëria bën pjesë janë:

Konventa e Parisit “Për mbrojtjen e pronësisë Industriale”, Traktatin e Budapestit “Për njohjen ndërkombëtare të depozitimit të mikroorganizmave për qëllime të procedurës së patentave”, Marrëveshja e Strasburgut “Për klasifikimin ndërkombëtare të patentave”, Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO⁴), Marrëveshja e TRIPS⁵-it Marrëveshja e Madridit “ Për regjistrimin ndërkombëtarë të patentave” etj.

⁴ WIPO – World Intellectual Property Organization

⁵ TRIPS - Trade-Related Aspects of Intellectual Property Rights

2.8. Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO)

2.8.1. WIPO – Historiku

“WIPO është një forum global për shërbime të Pronësisë Intelektuale, informacion dhe bashkëpunim. Është një organizatë e vetë-financuar e Kombeve të Bashkuara me 192 shtete anëtare.”(WIPO index page) Misioni i saj është të drejtoj zhvillimin e një sistemi internacional të balancuar dhe efikas të Pronësisë Intelektuale. Procedurat, mandatet dhe trupi qeverisës caktohen në Konventën e WIPO’s që u themeloi WIPO’n në vitin 1967 me bazë në Gjenevë të Zvicrës. Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO) promovon inovacionin dhe kreativitetin për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe kulturor të të gjitha vendeve, përmes një sistemi ndërkombëtar të pronësisë intelektuale të balancuar dhe efektive. WIPO është forumi global për shërbime, politika, informacion dhe bashkëpunim të pronësisë intelektuale (IP). Misioni WIPO është të udhëheqë zhvillimin e një sistemi IP të balancuar dhe efektiv ndërkombëtar që mundëson inovacionin dhe kreativitetin për të mirën e të gjithëve. Mandati, organet drejtuese dhe procedurat janë të përcaktuara në Konventën WIPO, e cila themeloi WIPO në 1967.

2.8.2. WIPO- Qëllimi

Si një organizatë ndërkombëtare qëllimi i WIPO’s është që të ndihmojë qeveritë, bizneset dhe shoqërinë të kuptojnë përfitimet e Pronësisë Intelektuale. Këtë ndihmë WIPO e ofron duke krijuar një forum politik që të krijojnë rregulla të balancuara në nivel ndërkombëtarë për Pronësi Intelektuale, shërbime globale që të mbrojnë Pronësinë Intelektuale përtej kufijve dhe zgjedhjen e mosmarrëveshjeve, një infrastrukturë teknologjike që lidh dhe e ndan këtë dituri, programe bashkëpunimi dhe zgjerimi që të mundësojë të gjitha shtetet të përdorin Pronësinë Intelektuale për përdorim ekonomik, shoqëror dhe zhvillim kulturor, dhe një data bazë ndërkombëtare për informacione për Pronësinë Intelektuale. Nëntë qëllimet strategjike të WIPO u miratuan nga vendet anëtare në dhjetor 2008 në fazën e parë të një procesi gjithëpërfshirës të riorganizimit strategjik brenda Organizatës. Ato pasqyrojnë sfidat në zhvillim për WIPO dhe për pronësinë intelektuale (IP) në mjedisin që ndryshon me shpejtësi:

1. Evolucionin e ekuilibruar të Kornizës Ndërkombëtare Normative për IP
2. Sigurimin e Shërbimeve IP Kryeministri Global
3. Lehtësimin e përdorimit të IP për Zhvillim

4. Koordinimi dhe zhvillimi i infrastrukturës globale të IP
5. Burimi i Referencës Botërore për Informacionin dhe Analizën e IP
6. Bashkëpunimi ndërkombëtar për ndërtimin e respektit për IP
7. Adresimi i IP në lidhje me çështjet e politikave globale
8. Një ndërfaqe e përgjegjshme e komunikimit midis WIPO, shteteve anëtare të saj dhe të gjithë palëve të interesuara
9. Një strukturë efikase e ndihmës administrative dhe financiare për të mundësuar WIPO për të ofruar programet e saj

Politikat kryesore dhe organet vendimmarrëse të WIPO janë: Asambleja e Përgjithshme dhe Komiteti i Koordinimit. Njëzet e një Asamble, dhe organet e tjera të shteteve anëtare të WIPO dhe të Sindikatave të administruara nga WIPO, takohen tradicionalisht në seancë të zakonshëm ose të jashtëzakonshëm në Vjeshtë⁶.

Këto takime bashkojnë shtetet anëtare të WIPO, duke i lejuar ata të marrin mundësinë e përparimit në punën e Organizatës dhe të diskutojnë mbi drejtimit e ardhshme të politikës. Divizioni i mbështetjeve të Asambleve dhe Dokumentacionit funksionon si sekretariat për organet drejtuese të WIPO.

2.9. Sistemi i Madridit

2.9.1. Zbatimi i Sistemit të Madridit

Sistemi i Madridit është një zgjedhje e përshtatshme dhe me një kosto efektive për menaxhimin dhe regjistrimin e markave tregtare në nivel global. Ky sistem mund të përdoret në qoftë se keni një lidhje personale apo keni biznes në njërin nga shtetet anëtare të këtij sistemi. Pra në qoftë se jeni banues, keni biznes industrial apo komercial apo jeni qytetar i njërit nga 122 shtetet anëtare që përfshihen në Sistemin e Madridit ju mund ta regjistroni markën tregtare. Menaxheri i Portofolit të Madridit është mjeti më efektiv për të menaxhuar një portofol të regjistrimeve ndërkombëtare nën Sistemin e Madridit. Përdoruesit mund të shohin aplikimet e tyre ndërkombëtare, regjistrimet ndërkombëtare në fuqi, si dhe

⁶ Njohuri nga ligjëratat e profesorit Dr.Sc. Altin Maliqi, të lëndës E Drejta mbi Pronësinë Intelektuale

ato që kanë përfunduar, të shohin statusin e tyre në Madrid Monitor, të konsultohen me historinë e tyre dhe të shkarkojnë kopjet elektronike të të gjitha dokumenteve të tyre, përfshirë certifikatat e tyre ndërkombëtare të regjistrimit. Aplikuesit gjithashtu, mund të rinovojnë regjistrimet e tyre ndërkombëtare dhe të paraqesin përcaktimet dhe kërkesat e mëpasshme për regjistrim për regjistrimet e tyre ndërkombëtare në fuqi. Duke pasur parasysh rrethanat aktuale, aplikantët, mbajtësit dhe përfaqësuesit e tyre inkurajohen fuqimisht që të mbështeten tek Menaxheri i Portofolit të Madridit për të menaxhuar regjistrimet e tyre ndërkombëtare, me qëllim që të marrin konsultimet e mundshme.

2.9.2. Kostot

Kostoja e regjistrimit të një marke tregtare internacionale përfshinë koston fillestare prej (653 CHF⁷ apo 903 CHF në qoftë se marka tregtare është me ngjyra), si dhe kosto shtesë varësisht se ku doni ta gëzoni mbrojtjen dhe sa lloje të të mirave dhe shërbimeve doni të mbroni me këtë markë. Pasi të merret marka tregtare internacionale atëherë aplikohen kosto shtesë në qoftë se dëshironi të zgjeroni mbulesën gjeografike (shtrirjen e efekteve), modifikimin si dhe ripërtëritjen e portfolios së markës. Çdo Palë Kontraktuese e Protokollit mund të deklarojë se, në lidhje me çdo regjistrim ndërkombëtar në të cilin është caktuar në bazë të Protokollit (qoftë në aplikacionin ndërkombëtar ose më pas), dhe në lidhje me rinovimin e një regjistrimi të tillë, ai dëshiron të marrë një të ashtuquajtur "tarifë individuale". Shuma e çdo tarife të tillë përcaktohet nga ajo Palë Kontraktuese dhe ajo duhet të tregohet në deklaratë; si dhe mund të ndryshohet nga një deklaratat pasuese. Kosto e regjistrimit mund të mos jetë më e lartë se tarifa që Zyra e Palës Kontraktuese do të merrte për regjistrimin e asaj marke për një periudhë dhjetë vjet, ose për rinovimin e një regjistrimi të tillë për një periudhë dhjetë vjet, pas zbritjes së kursimeve që rezultojnë nga procedurë ndërkombëtare. Kursime të tilla pritët të mblidhen, sepse, për shembull, procedura ndërkombëtare kursen Zyrat e Palëve Kontraktuese për ekzaminimin e formalitetit, klasifikimin e mallrave dhe shërbimeve, ose botimin e markës së regjistruar ndërkombëtarisht. Kostoja e një regjistrimi të markës tregtare ndërkombëtare përfshin tarifën bazë, plus kostot shtesë në varësi të vendit ku dëshironi të mbroni markën tuaj, dhe sa klasa të mallrave dhe shërbimeve do të mbulohen nga regjistrimi juaj. Pas marrjes së një regjistrimi të markës tregtare ndërkombëtare, tarifa shtesë aplikohen për të zgjeruar fushën e mbulimit gjeografik, modifikimin ose rinovimin e portofolit tuaj të markës tregtare.

Shqipëria u bë anëtare e Marrëveshjes së Madridit më 04.10 (tetor) 1995 ndërsa anëtare e Protokollit të Madridit u bë me 30.07 (korrik). 2003.

⁷ CHF – Franga Zvicëriane

2.10. Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI)

2.10.1. DPPI – Historiku

DPPI është institucioni i vetëm nëpërmjet të cilit shteti shqiptar jep të drejtat mbi patentat mbi shpikjet dhe modelet e përdorimit, topografinë e produkteve gjysmëpërçues, markat tregtare dhe të shërbimit, dizajnet industriale dhe treguesit gjeografikë, duke iu njohur mbajtësve të së drejtave pronësinë mbi këto objekte, nëpërmjet regjistrimit të tyre. Ky institucion është i ngarkuar me ligj për regjistrimin, administrimin dhe promovimin e objekteve të Pronësisë intelektuale detyrim i cili buron nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nga ligji “Për pronësinë intelektuale” si dhe nga dokumente tjera me rëndësi strategjike si: “Marrëveshja e Stabilizim Asocimit”, “Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale 2016-2020”, “Plani Kombëtar Integritimit Evropian 2018-2020” etj.

2.10.2. DPPI– Misioni

“DPPI ka mision të forcojë mbrojtjen e Pronësisë Industriale brenda territorit shqiptar nëpërmjet njohjes, regjistrimit dhe promovimit për të garantuar një nivel mbrojtjeje të njëjtë me atë të vendeve të Bashkimit Evropian.”(*DPPI Raporti vjetor 2018 f.17*) Fokus I DPPI-së është që të nxitë dhe të mbështetë inovacionin, nëpërmjet nxitjes së punës kërkimore nga kompanitë, universitetet dhe individët drejt zhvillimit ekonomik pra në mënyrë specifike të shërbej si një mjet për të inkurajuar investimet në kërkim dhe zhvillimi si dhe për të garantuar mbrojtjen dhe suksesin në treg. Kjo mbrojtje bazohet në legjislacionin kombëtar dhe në traktatat e konventat ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është anëtare.

Shërbimet që DPPI ofron janë: informative, bën regjistrimin e pronësisë industriale përmes ekzaminimit, organizimin e seminareve për ndërgjegjësimin e publikut, publikimin e buletineve dhe materialeve lidhur me të drejtat mbi pronësinë industriale, kryen trajnime të ndryshme etj.

Organet drejtuese të DPPI janë : Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm.




Figure 1 Rregullimi organizativ I brendshëm I DPPI-së

2.10.3. Baza ligjore kombëtare e DPPI

Legjislacioni I DPPI-së përcaktohet dhe rregullohet Ligji Nr.9947 “Për Pronësinë Industriale” ligje të tjera për mbrojtjen e Patentave dhe Shpikjeve, për mbrojtjen e Varieteteve Bimore, për Treguesit Gjeografik dhe Emërtimet e Origjinës, për Mbrojtjen e Dizajnëve Industriale, për Mbrojtjen e Markave Tregtare, si dhe Akte të tjera ligjore dhe nën ligjore që lidhen me fushën e zbatimit të mbrojtjes së pronësisë industriale si: Kodi penal i Republikës së Shqipërisë, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Kodi Administrativ, etj.

2.10.4. DPPI organizatat, marrëveshjet dhe traktatet

Gjithashtu pjesë e rëndësishme e legjislacionit të DPPI-së janë edhe konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare mbi Pronësinë Intelektuale që Republika e Shqipërisë ka nënshkruar si:

1. Konventa e Parisit “Për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale “,
2. Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO),
3. Traktatin e Budapestit,
4. Marrëveshja e Strasburgut,
5. Konventa Evropiane e Patentave,
6. Marrëveshja e Londrës,
7. Marrëveshja e Lisbonës,
8. Marrëveshja e Hagës,
9. Marrëveshja e Lokarnos,
10. Marrëveshja e Madridit,
11. Protokollin e marrëveshjes së Madridit,
12. Konventa e Nicës,
13. Organizata Botërore e Tregtisë (WTO⁸),
14. Marrëveshja e TRIPS, etj.

Pra Republika e Shqipërisë është anëtare e organizatave dhe marrëveshjeve më të mëdha botërore për Pronësinë Intelektuale dhe kështu ajo posedon një legjislacion të bollshëm që zbatohet me sukses të

⁸ WTO – World Trade Organization

lartë. DPPI si një kryes i këtyre shërbimeve tregon një sukses të madh në mbrojtjen dhe zhvillimin e mbrojtjes së Pronësisë Industriale si dhe zhvillimin e inovacionit, krijimtarisë dhe investimeve të reja në Republikën e Shqipërisë.

2.10.5. Strategjia e DPPI-së për vitet 2016-2020

Për vitet 2016-2020 në përputhjet me “Strategjinë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale” DPPI synon që të krijojë një sistem më të fortë dhe të konsoliduar të Pronësisë Industriale, të nxit zhvillimin e inovacionit, krijimtarisë, punës kërkimore në veçanti për universitetet, kompanitë dhe individët vendas në mënyrë të stimulojë më shumë ekonominë vendase.

Objektivat dhe produktet madhore të kësaj strategjie janë: Përmirësimi I kuadrit ligjorë, zhvillimi dhe forcimi I institucioneve të përfshira në zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, forcimi I bashkëpunimit si në nivel kombëtarë ashtu dhe në nivel rajonal dhe ndërkombëtarë si dhe rritja e ndërgjegjësimit të publikut në Republikën e Shqipërisë.

2.10.6. Raporti vjetor i vitit 2018 DPPI

“Gjatë vitit 2018 në DPPI janë depozituar **2235** aplikime të reja për regjistrimin e objekteve të Pronësisë Industriale krahasuar me vitin 2017 ku ishin **1993** ku është një rritje prej **12.14%** nga viti 2017 nga të cilat **1294** ishin aplikime për marka, **921** aplikime për patenta **16** aplikime për dizajnë industriale, **2** aplikime për tregues gjeografik dhe emërtues origjine dhe **2** aplikime për modele përdorimi.” (DPPI Raporti vjetor 2018 f.45) Viti 2018 ka qenë një ndër vitet më të suksesshme të DPPI-së dhe ka pasur numrin më të lartë të aplikimeve për marka.

Pra në të dhënat krahasimore në mes viteve **2017-2018** vërejmë dukshëm se në vitin **2018** ka pasur rritje të kërkesave për regjistrimin e patentave (**13.28%**), markave ‘*Sistemi I Madridit*’ (**4.17%**), dizajnëve (**23.08%**), treguesve gjeografik (**-66.67%**) dhe modeleve të përdorimit (**100%**)

“Në total DPPI për vitin 2018 ka hartuar dhe ka lëshuar 11,731 akte administrative në lidhje me objektet e Pronësisë Industriale si dhe ka publikuar 38 buletine zyrtare.”(DPPI Raporti vjetor 2018 f.45) Duhet të ceket se numri i aplikimeve për patentat kombëtare ka pësuar rënie nga viti 2017 ku nga 24 aplikime që ishin ka rënë në 15.

Table 1 Të dhëna Statistike 2016-2018

TË DHËNA STATISTIKORE 2016 - 2018

STATISTICAL DATA 2016 - 2018

PATENTA PËR SHPIKJE DHE MODELE PËRDORIMI INVENTION PATENTS AND UTILITY MODELS	2016	2017	2018
Kërkesa për regjistrimin e patentave kombëtare Request for registration of national patents	23	24	15
Kërkesa për regjistrimin e modeleve të përdorimit (kombëtare) Request for registration of utility models (national)	4	1	2
Kërkesa për shtrirje /vlefshmëri të patentave nga EPO Request for extension/validation of patents by EPO	720	789	903
Kërkesa për regjistrimin e patentave nga PCT Request for registration of patents by PCT	2	0	
Kërkesa për regjistrim ndërkombëtar të patentave Shqiptare Request for international registration of Albanian patents	0	1	0
Totali kërkesave për regjistrimin e patentave Total requests for registration of patents	745	813	921
Kërkesa për regjistrimin e certifikatës së mbrojtjes shtesë (SPC) Request for registration of supplementary protection certificate (SPC)	9	5	5
Kërkesa për ripërtëritjen e patentës Request for patent renewal	2772	3110	3338
Kërkesa për ndryshime në regjistrimin e patentave Requests for changes in the patents register	104	113	97
Kërkesa për rivendosje në afat të patentës Requests on renewal of the patent	4	7	9
Numri i patentave të regjistruara Number of registered patents	679	770	827
MARKA TREGTARE / TRADE MARKS			
Kërkesa për regjistrimin e markës në fazë kombëtare Request for registration of national trademark	1055	1161	1293
Kërkesa për regjistrimin e markave nga sistemi i Madridit Request for registration of trademarks from the Madrid system	2758	2622	2971
Totali kërkesave për regjistrimin e markave tregtare Total requests for registration of trademarks	3813	3783	4264
Aplikim për regjistrimin ndërkombëtar të markave Shqiptare Application for international registration of Albanian trademarks	6	11	16
Kërkesa për ripërtëritjen markave Request for patent renewal	625	515	517
Kërkesa për ndryshime në regjistrimin e markave Request for changes in the patents register	465	314	438
Numri i markave në fazë kombëtare të regjistruara Number of national registered trademarks	1053	803	790
Numri i markave të regjistruara nga sistemi i Madridit Number of trademarks registered from the Madrid System	2403	2731	2845
DISENJO INDUSTRIALE / INDUSTRIAL DESIGNS			
Kërkesa për regjistrimin e disenjove industriale Request for the registration of industrial designs	9	12	16
Totali kërkesave për regjistrimin e disenjove industrial Total requests for registration of industrial designs	10	13	16
Kërkesa për ripërtëritjen disenjove industriale Request for renewal of industrial designs	6	8	4
TREGUES GJEOGRAFIKË / GEOGRAPHICAL INDICATIONS			
Kërkesa për regjistrimin e treguesit gjeografik dhe emërtimeve të origjinës Request for registration of geographical indication and appellations of origin	2	6	2

Në vitin 2018 gati është dyfishuar (**73.65%**) nga viti 2015 numri i Patentave Evropiane që kërkojnë mbrojtje në Republikën e Shqipërisë.




Figure 2 Aplikimet e Patentave Evropiane në Republikën e Shqipërisë

Ky është indikatorë se më shumë kompani, zgjedhin të investojnë dhe të gëzojnë mbrojtje edhe në Republikën e Shqipërisë dhe tregon se sa e rëndësishme është anëtarësimi në organizata ndërkombëtare si dhe zbatimi I ligjit.

2.10.7. Markat Tregtare (DPPI)

Sa i përket markave tregtare në Shqipëri numri i aplikimeve kombëtare dhe ndërkombëtare në vitin 2018 ka arritur në **4171** aplikime. Në përgjithësi në krahasim me vitet e kaluara ka pasur rritje si në aplikimet për marka kombëtare dhe po ashtu në aplikimet për markat ndërkombëtare.

Numri total i aplikimeve për marka kombëtare në DPPI për vitin 2018 ishte **1294** krahasuar me **1161** aplikime në vitin 2017 duke shënuar një rritje prej **10.3%**. Ndërsa sa i përket regjistrimit të Markave në vitin 2018 ka pasur rritje numri i aplikimeve kombëtare ti cilat arritën në **905** duke shënuar rritje prej **24.4%** krahasuar me vitet paraardhëse. Gjithashtu është kryer me sukses klasifikimi ndërkombëtarë i elementeve figurative të markave sipas Klasifikimit të Vienës për aplikimet që janë ekzaminuar në vitin 2018. Pra ndër vite nga viti 2010 deri në 2018 është katërfishuar numri i aplikimeve të markave kombëtare dhe ka rritje me **24.4%** me vitin 2017. Aplikimet nga **Marrëveshje dhe Protokollit i Madridit** ne vitin 2018 janë depozituar **2877** aplikime **5.8%** se në vitin 2017.

Pra mund të vijmë në përfundim që nga viti në vit ka një rritje të konsiderueshme të aplikimeve për marka kombëtare si dhe atyre ndërkombëtare ku tregon aftësinë e DPPI-së dhe përkushtimin e tyre për të ndërgjegjësuar bizneset shpikësit e ndryshëm në RSH⁹.

Në raportin vjetorë 2018 të DPPI janë regjistruar gjithsej **816** marka ku prej tyre pjesën më të madhe e bëjnë ato të vitit 2017, **176** regjistrime i takojnë vitit 2018 dhe vetëm një pjesë e vogël i takon vitit 2016.

Numrin më të madh të aplikuesve sipas vendit të origjinës e përbëjnë aplikuesit vendorë me 76% dhe më pas ndjekjen nga SHBA-të me 9% dhe vendet tjera si Mbretëria e Bashkuar, Zvicra, Kosova, Serbia etj janë nga vendet që kanë numrin më të madh të aplikuesve.

2.10.8. Dizajnet industriale dhe të dhënat statistikore

Dizajnet industriale përbëjnë aspektin estetik apo ornamental të një prodhimi. “Në përgjithësi shifrat për aplikimin e dizajnëve industriale janë më të ulëta se sa ato për aplikime markash apo patenta. Këto aplikime ekzaminohen nga Sektori i Ekzaminimit të Markave Tregtare dhe të Shërbimit, Dizajneve Industriale dhe Treguesve Gjeografik. Gjatë vitit 2018 janë depozituar 16 aplikime për regjistrimeve të DI ndërsa në vitin 2017 ishin depozituar vetëm 12 aplikime duke shënuar rritje prej 25%”(*DPPI Raporti vjetor 2018 f.68*)

“Nga Marrëveshja e Hagës në vitin 2018 janë regjistruar 119 DI me 499 dizajne të shumëfishta si dhe 242 ripërtërije dizajnoje me 718 dizajne të shumëfishta. Nga kjo marrëveshje në vitin 2018 ka pasur 137 aplikime për DI ¹⁰me 556 dizajne të shumëfishta.”(*DPPI Raporti vjetor 2018 f.69*)

2.10.9. Treguesit gjeografik

Treguesit gjeografik dhe emërtimet e origjinës përdoren në tregti për të treguar origjinën gjeografike të produkteve. Emërtim origjine quhet emri që e identifikon një produkt, pra që ka origjinën nga një vend specifik, rajon apo edhe një shtet, cilësitë e së cilit vijnë ekskluzivisht ose esencialisht, si një rezultat i një mjedisi specifik gjeografik të veçantë që përfshinë faktorët natyrorë, njerëzorë të trashëguar nga ky mjedis hapat për prodhimin e të cilit realizohen në atë zonë specifike gjeografike. Ndërsa tregues gjeografik quhet një produkt me origjinë në një vend specifik, rajon apo shtet cilësitë e së cilit i

⁹ RSH – Republika e Shqipërisë

¹⁰ DI – Dizajn Industrial

atribuohen esencialisht origjinës së tij gjeografike ose të paktën një nga hapat prodhues të realizohet në zonën e përcaktuar gjeografike.

“Me aderimin e RSH në Aktin e Gjenevës dhe në marrëveshjen e Lisbonës DPPI tashmë siguron mbrojtje ndërkombëtare të treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës.”(*DPPI Raporti vjetor 2018 f.72*)

2.11. Agjensioni për Pronësi Industriale (API)

2.11.1. API – Historiku

Agjencia për Pronësi Industriale është një organ qendror administrativ i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe është përgjegjës për mbrojtjen ligjore të shpikjes, markës tregtare, dizajnit industrial, emërtimit të origjinës, treguesve gjeografik, dhe topografive të qarqeve të integruara, si dhe çështjeve tjera që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare nënshkruese e të cilave është Republika e Kosovës. API është përgjegjëse për: zhvillimin e procedurave për lëshimin e patentave, certifikatave suplementare të mbrojtjes së shpikjes, regjistrimin e MT, DI, TQI, EO, TG, përpilimin dhe mirëmbajtjen e regjistrimit të përcaktuar me ligjin bazë, propozimin, hartimin dhe publikimin e buletinit zyrtarë të API-së, kontributit në zhvillimin e mbrojtjes së PI-së, ofrimin e shërbimeve informuese mbi PI si dhe përfaqësimin e RK¹¹-së në organizatat ndërkombëtare të PI-së.

Vlen të ceket se API është një agjencion relativisht i ri ku në vitin 2018 kishte 10 vjetorin e saj dhe në krahasim me DPPI vazhdimisht është në sfida të ndryshme pasi që RK ende nuk bën pjesë në organizatat kryesore të PI megjithatë API vazhdon me një përkushtim të madh të zhvillohet si një agjencion dhe duke kontribuar në informimin dhe zhvillimin e PI në Republikën e Kosovës duke marrë parasysh të gjitha bllokadat politike e ekonomike që i shfaqen këtij agjencioni.

“Gjatë kësaj periudhe kohore API ka pranuar **9782** shkresa të ndryshme ku vërehet një rritje e ndjeshme e numrit të dokumenteve hyrëse në këtë agjencion. Ky shtim më së shumti i atribuohet vazhdimin të markave tregtare të vitit 2008 që pra në vitin 2018 korrespondon me 10 vjetorin e aplikimit.” (*API Raporti vjetor 2018.f.2*)

¹¹ RK – Republika e Kosovës

Table 2 Statistika e shkresave të pranuar në vitin 2018 në API

Marka Tregtare aplikime	1716
Patenta aplikime	21
Dizajn industriale aplikime	15
Kërkesa për vazhdime të markave tregtare	3254
Kërkesa për ndryshime në regjistër të markave tregtare, patentave dhe dizajneve industriale	1309
Kërkesa për plotësime të Markave Tregtare, taksa për lëshimin e vendimit dhe taksa për lëshimin e certifikatës për Marka Tregtare, pagesa të patentave	1761
Kërkesa për kufizimin e listës së produkteve	11
Kërkesa për ekzaminimin e parakohshëm të Markave Tregtare	3
Autorizime	168
Kërkesa për mbajtje në fuqi të patentave	419
Kundërshtime të Markave Tregtare	80
Kërkesa për zgjatje afati	7
Kërkesa për heqje dorë të Markave Tregtare dhe Patentave	20
Kërkesa për korrigjimin e vendimeve dhe aplikimeve	411
Kërkesa për ekstrakt regjistri	30
Kërkesa për tërheqje të kundërshtimit	4
Dokumente prioriteti	69
Kërkesa për informacione të Markave Tregtare dhe Patentave	50
Mirëmbajtje vjetore të licencës së përfaqësuesve	28
Ankesa kundër vendimeve të API-së	49
Kërkesa për shfuqizimin e vendimeve	6
Vendim i komisionit të ankesave	9
Kërkesa për vazhdimin e dizajnit industrial	12

2.11.2. API - Patentat

“Numri i aplikimeve të patentave ka rënë gradualisht ndër vite dhe kjo ndodh kryesisht për shkakun e mos anëtarësimit të RK në EPO¹², si dhe industrisë jo të zhvilluar kopjuese të tregut të Kosovës. Aplikuesit e patentave me rastin e aplikimit në shtete të caktuara shikojnë së pari interesin e shitjes së patentës së tyre dhe zhvillimin e industrisë së atij vendi. Me rastin e anëtarësimit të RK në Zyrën Evropiane të Patentave (EPO), pritet të shtohen aplikimet e patentave pasi që aplikuesit i kushton më lirë mbrojtja përmes EPO, duke krahasuar me mbrojtjen kombëtare që aplikohet tashmë në Republikën e Kosovës.” (API Raporti vjetor 2018 f.3)

Në vitin 2018 janë shqyrtuar 98.06% të aplikacioneve dhe nuk ka backlog* ndërsa pjesa tjetër ekzaminohen me kohë pas kalimit të periudhës 18 mujore, që është standard ndërkombëtar i kohës së qëndrimit të aplikimit pa u publikuar.

Gjatë këtij viti 2018 janë **21** aplikime të patentave ndërsa **3** janë vendore që tregon se ka një ulje në aplikime prej **36.3%** nga viti 2017 ku ishin **33** aplikime.

2.11.3. API - Markat Tregtare

Numri i aplikimeve të markave tregtare ka shënuar rritje prej **8.95%** në vitin 2018 krahasuar me vitin paraprak. Rritja e numrit të aplikimeve e sidomos atyre aplikimeve vendore i atribuohet aktiviteteve të realizuara nga API për ngritjen e vetëdijes mbi rëndësinë e mbrojtjes së produkteve dhe shërbimeve me markë tregtare si dhe me seminare të ndryshme, konferenca, promovime në media etj. të mbajtura gjatë vitit 2018.

“Sa i përket efikasitetit të API si agjencion në vitin 2018 ka shënuar rritje në reduktimin e backlog* nga **86.52%** në vitin 2017 në **91.59%** në vitin 2018 përkundër faktit që numri i aplikimeve u rrit me **1716** nga viti 2017.” (API Raporti vjetor 2018 f.4)

¹² EPO – European Patent Office





Figure 3 Statistika për aplikimin e Markave Tregtare API

2.11.4. API - Dizajnet Industriale

“Numri i aplikimeve të DI është relativisht i njëjtë me vitet e kaluara. Pra si tek patentat njëjtte edhe tek Dizajnet industriale numri i aplikimeve nuk është i kënaqshëm, jo për shkakun e zhvillimit industrial dhe produkteve të reja në Republikën e Kosovës.” (API Raporti vjetor 2018 f.6) Me dizajn industrial mbrohet dukja e jashtme e produktit dhe pra sigurohet që ai produkt të ketë karakter individual pra të jetë një lloj risie në fushën përkatëse. Gjatë vitit 2018 API ka rekrutuar zyrën përkatëse për shqyrtimin e dizajneve industriale. Po ashtu gjatë këtij viti janë shqyrtuar gjithsej **75** aplikime të dizajneve industriale dhe parashihet që të përfundohet me shqyrtimin e tyre në kuartalin e dytë të vitit 2019.

Figure 4 Statistika mbi numrin e aplikimeve për Dizajn industrial në API



2.11.5. API - Treguesit Gjeografik

“Në 2018 është miratuar Udhëzimi Administrativ nr. 09-2018 për Përcaktimin e Simboleve për Treguesit Gjeografik, Emërtimit të Origjinës dhe Specialitetit Tradicional të Garantuar.” (*API Raporti vjetor 2018 f.7*) Gjithashtu API ka organizuar disa aktivitete në fushën e Treguesve Gjeografik të mbështetura nga projektet e Bashkimit Evropian (EU) si dhe nga Ambasada Franceze si: Takimi me drejtues të Shoqatës së prodhuesve të Djathit të Sharrit, Seminari për finalizimin e Specifikacionit të Djathit të Sharrit si produkt potencial për tu mbrojtur si tregues gjeografik në RK, si dhe qëndrimi i ekspertës në fushën e treguesve gjeografik Ester Olivas Caceres ku ka analizuar dhe ka përgatitur rekomandimet mbi fushën e treguesve gjeografik.

Edhe pse janë mbajtur të gjitha këto takime me përdorues të mundshëm të mbrojtjes mbi treguesit gjeografik, Shoqata e prodhuesve të Djathit të Sharrit asnjëherë nuk ka aplikuar në API për regjistrimin e treguesit gjeografik që tregon se ende ka punë për të vetëdijesuar bizneset e ndryshme për perfitimet e pronësisë industriale.

2.11.6. Digjitalizimi i API

Në vitin 2018 është përfunduar skanimi, ri-arkivimi i 26000 aplikimeve të markave tregtare. API është në fazën përfundimtare të instalimit të versionit të ri të WIPO Publish që do të realizohet gjatë vitit 2019, version që përmirëson qasjen e palëve në kërkim për objekte të pronësisë industriale dhe jep një pasqyrë më të saktë të kërkimit.

2.11.7. Të hyrat financiare të API

“API në vitin 2018 ka realizuar të hyra financiare në shumën e 589,911.00 euro. Ku për realizimin e këtyre të hyrave janë gjeneruar 9043 fletëpagesa. API ka sistemin e saj online të gjenerimit të fletëpagesave sistem i cili ka mundësuar reduktimin e kohës për aplikim dhe qasje më të lehtë në shërbimet e API.” (*API Raporti vjetor 2018 f.17*)




Figure 5 Të hyrat financiare të API ndër vite

3. Deklarimi i problemit

Pronësia industriale është një ndër problemet kyçe që bizneset, individët dhe shpikësit përballen në baza ditore. Është e rëndësishme që shteti ti kushtojë vëmendje sa më të madhe rregullimit të kornizës ligjore, nënshkrimit të konventave të ndryshme ndërkombëtare, si dhe lehtësimit të faktorëve mbrojtës për këto subjekte. Me këtë punim diplome është bërë krahasimi në mes të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës duke krahasuar aftësinë e agjensioneve të pronësisë intelektuale në këto shtete si dhe rezultatet e tyre në këtë fushë.

Kemi arritur të kuptojmë se Republika e Shqipërisë pasi që është anëtare e disa konventave ndërkombëtare tregon suksese më të mëdha në mbrojtjen dhe ndërgjegjësimin e bizneseve, individëve dhe shpikësve në fushën e pronësisë industriale, ndërsa Republika e Kosovës duke marrë parasysh rrethanat e ndryshme politike, ekonomike, dhe shoqërore edhe pse me një legjislacion të bollshëm mos prania apo jo anëtarësimi në disa organizata ndërkombëtare (EİPO) nuk i ofron siguri të mjaftueshme këtyre subjekteve që të kërkojnë mbrojtje të pronësisë industriale siç e bëjnë në Republikën e Shqipërisë. Kjo mund të konstatohet edhe në analizat e raporteve vjetore të këtyre dy shteteve ku vërehet se në Republikën e Shqipërisë infrastruktura e agjensionit për pronësi industriale është më e mire dhe numri i aplikimit për patenta është dukshëm më i madh se sa që është në Republikën e Kosovës .

4. Metodologjia

Në këtë punim të diplomës është bërë krahasimi në mes të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës ku burim i të dhënave kanë qenë kryesisht agjensionet përkatëse të këtyre shteteve pra DPPI dhe KIPA. Qëllimi i përdorimit të mënyrës krahasimore ishte që të kuptojmë dallimet në punën e kryer nga këto dy agjenci si dhe dallimet që këto dy shtete kanë pasi që Republika e Shqipërisë është anëtare e disa konventave ndërkombëtare për pronësinë industriale ndërsa Republika e Kosovës edhe pse me legjislacion të bollshëm jo anëtarësia në këto konventa bën që të ketë mungesë interesimi sa i përket pronësisë industriale në këtë vend.

5. Konkluzioni

Në këtë punim krahasimor u përshkrua gjendja e dy Agjencioneve të Pronësisë Industriale nga Kosova dhe Shqipëria duke shpjeguar dhe analizuar raportet vjetore të dy agjencioneve përkatëse dhe sidomos duke i krahasuar në fushën e volumeve që këto dy agjencione kanë në regjistrat e tyre. Gjithashtu pamë dallimin në volume të aplikimeve dhe se sa e rëndësishme është anëtarësimi në organizatat e ndryshme botërore të Pronësisë Industriale.

Gjatë analizës së këtyre agjencioneve pra Agjencinë për Pronësi Intelektuale dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Intelektuale konstatuam se:

1. Regjistrimi në këto institucione siguron autorit, shpikësit, bizneset dhe individët që dëshirojnë të mbrojnë pronësitë e tyre intelektuale.
2. Pamë se si në Republikën e Kosovës, API has në shumë vështirësi për shkak se Republika e Kosovës nuk është anëtare e organizatave për mbrojtjen e Pronësisë Industriale WIPO dhe ka mjaft mangësi në drejtim të përsosjes të njohurive dhe ndërgjegjësimit, botëkuptimit komunitar, si dhe se nuk është i favorshëm për biznese aplikimi në API.
3. Ndërsa këto sfida tanimë janë kaluar nga DPPI dhe Drejtoria për të Drejtën e Autorit, ku Republika e Shqipërisë përveç se është anëtare në organizata, dhe traktate të ndryshme të Pronësisë Intelektuale dhe sidomos të Pronësisë Industriale, ku edhe shënon rritje të aplikuesve nga viti në vit me qëllim regjistrimin e aseteve të ndryshme pronësore në këtë fushë të së drejtës.
4. Gjithashtu vlen të ceket se në Republikën e Kosovës rol jo pozitiv luajnë edhe faktorët politik, marrëdhëniet fqinjësore jo të mira me disa vende dhe se vendi ende konsiderohet të jetë në fazë tranzicioni, gjë e cila nuk i siguron aplikantët e huaj apo vendorë ti besojnë API-së.

6. Referencat

- Njohuri nga ligjëratat e profesorit Dr. Sc. Altin Maliqi, të lëndës E Drejta mbi Pronësinë Intelektuale
- Raporti Vjetor i Aktivitetit të DPPI gjatë vitit 2018 (PDF) <http://www.dppm.gov.al/>
- LIGJ Nr. 9947, datë 7.7.2008 “PËR PRONËSINË INDUSTRIALE”, i ndryshuar

WIPO – në historikun e kësaj organizate <https://www.wipo.int/portal/en/index.html>

Webfaqja zyrtare e DPPI – raporti vjetor 2018 , <http://www.dppm.gov.al/>

Webfaqja zyrtare e API legjislatura e Republikës së Kosovës <https://kipa.rks-gov.net/desk/inc/media/FEC9AC30-B6AD-45B5-88B7-A31734BE41D9.pdf>

Webfaqja zyrtare e API raporti vjetor 2018 <https://kipa.rks-gov.net/desk/inc/media/D61B2DCA-D7A5-498C-B9C4-4A6D1BD67F10.pdf>

Webfaqja zyrtare e API LIGJI Nr. 05/L-051 PËR TREGUESIT GJEOGRAFIK DHE PËR EMËRTIMET E ORIGJINËS <https://kipa.rks-gov.net/desk/inc/media/D3EC5FAB-8B53-4E00-8C53-86EC93808892.pdf>

Webfaqja zyrtare e API LIGJI Nr. 04/L-029 PËR PATENTA <https://kipa.rks-gov.net/desk/inc/media/D0B8D5FF-E44D-466A-AE63-A2498BB95F20.pdf>